



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Vend. nr. 01 / 539 / Dt. 27 / 05 /2020

Menaxhmenti i Universitetit dhe Kolegjiumi i Dekanëve të njësive akademike në takimin e së martës të mbajtur online, më 26.05.2020, mori

V E N D I M

Për organizimin dhe përcaktimin e datave për mbajtjen e provimeve për dy afatet prill – qershor 2020 të nivelit bachelor dhe master

Afati i prillit:

1. Paraqitja e provimeve do të hapet nga data: 27.05.2020 deri më 31.05.2020;
2. Dekanët e njësive akademike do të organizojnë mbajtjen e provimeve nga data: 01.06.2020 deri më 07.06.2020;
3. Nga data 07.06.2020 deri me 14.06.2020 duhet të vendosen notat në SMU.
4. Më 14.06.2020 mbyllet SMU për afatin e prillit.

Afati i Qershorit:

1. Afati për paraqitjen e provimeve do të hapet më 15.06.2020 deri më 18.06.2020;
2. Provimet do të mbahen nga data 19.06.2020 deri më 17.07.2020;
3. Nga data 19.06.2020 deri me 19.07.2020, SMU do të jetë hapur dhe mundë të vendosen notat në sistem.
4. Më 19.07.2020 mbyllet SMU për afatin e provimeve të qershorit.
5. Më 20.07.2020 hapet SMU për paraqitjen e temave të diplomës;
6. Deri më 30.07.2020 mbahen provimet e diplomës.

Vendimit i bashkëngjiten këto udhëzime:

1. Numrin e studentëve nëpër salla do ta caktojnë dekanët duke e respektuar distancën mes tyre;
2. Provimet gjatë ditës do të mbahen nga ora 9.00 deri në orën 18.00;
3. Secili student për një grup duhet ta ketë testin e veçantë;
4. Secili student duhet të vendosë **maskën** në fytyrën e tij;
5. Në çdo kat duhet të ketë **dezinfektues**;

6. Dekanët duhet t'i sigurojnë zëvendësimet për mbajtjen e provimit për profesorët të cilët nuk mundë të vijnë nga Maqedonia apo Lugina;
7. Dekanët duhet t'i paralajmërojnë profesorët se nuk guxojnë të shkaktojnë vonesa në vendosjen e notave në SMU.

Shënim: Për studime Master organizimin e provimeve do ta bëjnë kordinatorët e programeve.

REKTORI



Prof. Asoc. Dr. Bajram Kosumi

